



Republika e Kosovës

Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Komuna e Ranillugut

Opština Ranilug - Municipality of Ranilug

03-2-287 / No./ 2023

19.06.2023

KOMUNA E RANILLUGUT



KORNIZA VJETORE BUXHETORE (KAB) KOMUNALE RANILLUG 2024-2026

Kuvendi i Komunës

DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANC

Përmbajtja

I. Hyrje

II. Deklarata e Komunës në lidhje me prioritetet strategjike zhvillimore

III. Korniza Fiskale

3.1 Korniza makroekonomike komunale

3.2 Tendenca e të hyrave komunale dhe parashikimet 2024-2026

3.3 Donatorët e jashtëm

3.4 Politikat e reja

3.3 Tendenca e shpenzimeve komunale dhe parashikimet 2024-2026


IV. Korniza e Përfomancës së Shpenzimeve

I. Hyrje

Korniza Vjetore Buxhetore, KAB, që po prezantohet është një dokument i cili miratohet në parim çdo vit nga Asambleja Komunale. Ky material siguron një analizë të hollësishme të shpenzimeve publike dhe përcakton parametrat dhe prioritetet kryesore për zhvillimin e vazhdueshëm të buxhetit vjetor. Gjithashtu, KAB, siguron mekanizmat e nevojshme, përmes të cilave, objektivat prioritarë, të identifikuar në dokumentet strategjike të komunës, aty ku ekzistojnë, të integrohen sa më mirë në procesin buxhetor.

Hartimi i Kornizës Vjetore Buxhetore përbën një detyrim për institucionet buxhetore komunale të kërkuar nga Qarkoret Buxhetore Komunale 2023/2025 të pranuar nga Ministria e Financave.

Ky dokument do të jetë baza për përcaktimin e sektoreve prioritare të zhvillimit dhe identifikimin e prioritetëve të shpërndarjes së burimeve komunale për periudhën 2024-2026. Janë katër faza të përmbledhura për zhvillimin e KAB Komunale dhe afatet kohore, si në figurën e mëposhtme:



Procesi Buxhetor për vitin 2023

II. Deklarata e Komunës në lidhje me prioritetet strategjike zhvillimore

Komuna e Ranillugut është një komunë e sapokrijuar në Kosovë, e vendosur në jug të Kamenicës së Kosovës në shpatet e Malit të Zi të Shkupit dhe ndodhet në 603 m mbi nivelin e detit, duke prekur rrafshin e lumit Binacka Morava. Ostrovica është maja më e lartë me 1166 m mbi nivelin e detit. Sipërfaqja e komunës është 77.62 km².

Komuna është themeluar më 5 janar 2010 dhe ka 13 zona kadastrale: Ranillug, Bozhevce, Veliko Ropotovë, Glogovce, Gornje Korminjane, Donje Korminjane, Domorovce, Drenovce, Malo Ropotovo, Odevce, Pancelo, Rajanovce, Tomance. Popullsia e Ranillugut është 5800 banorë, prej të cilëve 98,6% janë Serbë dhe 1,4% Shqiptarë. Sipas regjistrimit të fundit të vitit 2011, komuna e Ranillugut ka 3866 banorë, gjë që e konsiderojmë jorale sepse një pjesë e mirë e popullsisë nuk iu përgjigj regjistrimit. Për këtë arsye, komuna është dëmtuar gjatë Grantit të Përgjithshëm çdo vit fiskal.

Në bazë të të dhënave që disponon sektori për zhvillim ekonomik në komunën e Ranillugut numërohen mbi 143 subjekte ekonomike, si vijon: produktet 9, shërbimi 3, katering 15 dhe tregtia 116.

Vizioni për komunën e Ranillugut i përcaktuar pas konsultimeve me aktorë të rëndësishëm të jetës politike, ekonomike dhe sociale në komunë bazohet në dokumentet e strategjisë Vjetore dhe afatgjatë, të cilat komuna i ka zhvilluar si::

1. Plan i Zhvillimit Komunal dhe Urban 2013-2020
2. KASH i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2024-2026

Vizioni i Komunës për tri vitet e ardhshme është për Ranilug, si një qendër e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik, me shërbime efikase e kualitative për qytetarët, i integruar në proceset rajonale të zhvillimit, si një qendër e kulturës së pasur, arsimitit dhe jetës sportive, dhe ofrimit të një kualiteti të mirë të jetesës për qytetarët e saj.

Atributet më të rëndësishme të çfarëdo dokumenti të planifikimit strategjik dhe vizionit të definuar janë së pari lehtësia e komunikimit si dhe së dyti llogaridhënia. Me qëllim të përmblotjes së këtyre dytribute binjake prioritet strategjike të Komunës në periudhën Vjetore janë grupuar në katër fusha prioritare që do të mundësojnë realizimin e qëllimit të vizionit tonë për Komunën.

Fushat me prioritet dhe objektivat e kornizës Vjetore komunale 2024-2026 për Komunën e Ranillugut janë:

➤ 1. Forcimi i Ekonomisë Komunale me mundësi për të gjithë

Rritja e ekonomisë komunale përmes:

- Përmirësimi të standardeve të arsimitit dhe nivelit të arritjes
- Mbështetjes direkte të sektorit bujqësor

➤ 2. Përmirësimi i shëndetësisë dhe mirëqenies së qytetarëve

Krijimi dhe ndihma për qytetarët për të pasur jetë të shëndetshme dhe aktive në komunitetin e tyre përmes:

- Ndërtimit të objekteve të banimit për familjet e varfëra
- Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve shëndetësore
- Përmirësimi i infrastrukturës në objektet sportive e kulturore

3. Përmirësimi i ambientit të Komunës dhe qëndrueshmëria e tij

Absorbimi i popullatës në rritje në komunë dhe njëkohësisht mbrojtja e ambientit përmes:

- Planifikim i planeve zhvillimore dhe urbane të komunës
- Përmirësimi dhe rigjenerimi të infrastrukturës
- Përmirësimi të standardeve ambientale

4. Të bëhet Komuna vend më i sigurtë dhe i drejtë/fer për qytetarët e saj

- Përmirësimi i bashkëpunimit ndër-etnik përmes krijimit të kushteve me të mira për zyrën e Komuniteteve për të ofruar shërbime për qytetarë

III. Korniza Fiskale Komunale

3.1 Ndonëse komuna nuk udhëheqë drejtpërdrejt politiken makroekonomike (kjo është kompetencë e qeverisë qendrore) mjedisi i përgjithshëm ekonomik ndikon në pasqyren fiskale komunale dhe si i tillë do të trajtohet si vijon, shih tabelën më poshtë. Korniza Vjetore Buxhetore e Komunës është në përputhje me kornizën makroekonomike të Kosovës dhe sipas dokumentit Korniza Vjetore të Shpenzimeve (KASH) 2024-2026 të përpiluar nga Qeveria e Kosovës.

Komponentet e politikës makroekonomike sic janë Bruto Produkti Vendor, inflacioni dhe domografia duhet konsideruar dhe marrë parasysh. Korniza Vjetore e Shpenzimeve 2024-2026 e Qeverisë së Kosovës bazuar në të dhënat historike si dhe në zhvillimet e fundit ekonomike, nënvizon faktin se do të ketë ecuri pozitive të rritjes ekonomike në vitet e ardhshme, më saktësisht në periudhën 2024 -2025 parashihet një rritje reale vjetore 3.8% në vitin 2021, ndërsa rritja reale e Bruto Produktit të Vendi në 2023 dhe 2024 parashihet të jetë 4.0% respektivisht 4.2%.

Natyrisht se rritja ekonomike ndryshe përkthehet edhe në krijimin e vendeve të reja të punës dhe zbutjen e papunësisë në Komunë që aktualisht llogaritet të jetë rreth 19.31 % (Nga zyra e punimit ne evidencen qe kerkojne pune jane te evidentuar 1300 pune kerkues mirpo ne mendojme se keto te dhena nuk korespondojne me gjendjen reale ne teren dhe mendojm se perqindja mund te jete me e theksuar).

Komuna nga ana e saj do të adaptojë legjislacionin përkatës në funksion të krijimit të ambientit më të mirë për sektorin privat dhe rritjes së të ardhurave të tyre, rrejdhimisht rritjes së të hyrave buxhetore komunale.

Aktualisht financimi komunal përfshinë:

- 1. Të Hyrat Vetanake
- 2. Grantet Operative.

Komuna në periudhën Vjetore buxhetore 2024-2026 nuk planifikon të marrë hua nga institucione financiare për të financuar projektet e saj, sic e ka lejuar Ligji për Financat Publike dhe Llogaridhënie.

Tabela 1: Indikatorët ekonomik komunal


Përshkrimi	2022 (aktual)	2023	2024	2025 (vlerësim)
Indikatorët makroekonomik në Kosovë				
Rritja reale e BPV në %	3.8	4.0	4.2	4.3
Inflacioni në %	1.1	1.1	2	2
BPV për kokë banori, në euro	3.4	3.7	4.1	4.3
Indikatorët ekonomik komunal				
Popullsia e Komunes	6,729	6,729	6,789	6,759
Numri i bizneseve të regjistruara	330	360	390	420
Numri i nxënësve	1,350	1,360	1,370	1,380

Burimi: Korniza Vjetore e Shpenzimeve, Qeveria e Kosovës, 2024-2026

3.2 Tendenca e të hyrave komunale dhe parashikimi afat-mesëm 2022-2024

Të hyrat e Komunes së Ranilug nga dy burimet e saj kryesore – grantet qeveritare si dhe të hyrat vetanake komunale kanë shënuar ulje nga viti në vit.

Figura 1: Buxheti Total i Komunes në vite (2021 – 2024), milion Euro:



Në bazë të planifikimit të bërë nga viti 2022- grantet qeveritare për Komunën e Ranillug

si tërësi do të shënojnë rritje në përqindje.

Të hyrat vetanake komunale, në anën tjetër, planifikohet të shënojnë rritje të dukshme nga viti në vit, po ashtu. Nëse shohim të dhënat e vitit 2022 dhe krahasojmë me planin afatmesëm të realizimit të të hyrave vetanake do të shohim një rritje të të hyrave të planifikuara në vitet në vijim. Kjo rritje kryesisht i atribuohet planit në grupbulimit më efikas të tatimit në pronë sidomos si rezultat i rritjes së bazës tatimore të komunës me faktin se procesi i decentralizimit ka sjellur më shumë zona kadastrale respektivisht objekte që tatimohen për komunën, rrjedhimisht dhe më shumë të hyra, si dhe rritjes së normave tatimore në pronën e paluajtshme nga 0.08% në 0.15%, prag ky i caktuar përmes Ligjit mbi Pronën e Paluajtshme të amandamentuar nga Parlamenti i Kosovës. Si shtesë, komuna planifikon në rritjen e të hyrave nga lejet e ndërtimit që pritet të lëshojë si rezultat i kërkesave të shtuara të qytetarëve, për faktin se komuna është rritur territorialisht si rezultat i decentralizimit dhe ndërtimit të objekteve rekreative kryesisht nga sektori privat, përveq nëse Qeveria e Republikës së Kosovës në të ardhmen zyrtarizon paralajmërimet në centralizimin e kësaj lloji të hyre, gjë që do të ndikonte buxhetin e Komunës së Ranillugut.

Tabela 2: Planifikimi i të hyrave vetanake komunale sipas burimit për periudhën 2024-2026, në euro

Komuna: Ranillug	Komuna: Ranillug	Grantovi i SP- 2023. (ove godine)		Grantovi i SP - 2024 (godina 1)		Grantovi i SP - 2025(godina 2)		Grantovi i SP - 2026(godina 3)	
		U evrima		U evrima		U evrima		U evrima	
BURIMET	BURIMET E TË ARDHURAVE	1.790.463		2.127.340		2.238.674		2.346.684	
0 GRANTET		1.043.474		1.149.762		1.226.550		1.298.717	
Grant i	Grant i përgjithshëm	503.814		716.638		738.137		760.281	
Grant	Grant arsimor	134.900		269.940		273.987		287.686	
Granti	Granti shëndetësor								

1 Licenca për lojëra argëtuese, reklama, etj.	1 Licenca për lojëra argëtuese, piçe alkoolike, reklama, reklama, etj.				
Funksiononi me makina kartëmoshesh ose lojëra të	Funksiononi me makina kartëmoshesh ose lojëra të				
2 Përdorimi i tokës dhe leje ndërtimi	2 Përdorimi i tokës dhe leje ndërtimi	15,000	15,000	17,000	19,000
Lejet e ndërtimit dhe ndërtimet	Lejet e ndërtimit dhe ndërtimet	15,000	15,000	17,000	19,000
3 Inspektimi i tokës dhe aktivitetet gjeodezike	3 Inspektimi i tokës dhe aktivitetet gjeodezike	6,200	6,200	7,000	7,800
Përgatitja e planit urbanistik dhe inspektimet lidhur me planin	Përgatitja e planit urbanistik dhe inspektimet lidhur me planin	1,200	1,200	1,500	1,800
Aktivitetet	Aktivitetet në terren lidhur me vendet e matura	5,000	5,000	5,500	6,000
4 Shërbimet e inspektimit të shëndetit dhe sigurisë	4 Shërbimet e inspektimit të shëndetit dhe sigurisë				
Inspektimi i inspektimit i objekteve që ofrojnë ushqim dhe akomodim	Inspektimi i inspektimit i objekteve që ofrojnë ushqim dhe akomodim				
Inspektimi i inspektimit i ambientit	Inspektimi i inspektimit i ambientit				
Inspektim ndërtimi, shërbim ziarrfikës dhe ndërtim	Inspektim ndërtimi, shërbim ziarrfikës dhe ndërtim				
5 Shfrytëzimi i pronës komunale	5 Shfrytëzimi i pronës komunale				
Baza ditore ose tjetër për shfrytëzimin e pronës publike për ose tjetër veprimtari tregtare ose jokomerciale	Baza ditore ose tjetër për shfrytëzimin e pronës publike për veprimtari tregtare ose jokomerciale				
6 Pagesa për automjete	6 Pagesa për automjete	8,500	8,500	9,000	9,500
Leje drejtimi	Leje drejtimi	8,500	8,500		
Parkimi në një parkim publik të pajisur me një garazh ose një narkim	Parkimi në një parkim publik të pajisur me një garazh ose një narkim				
Regjistrimi i automjeteve	Regjistrimi i automjeteve	8,500	8,500	9,000	9,500
7 Certifikata dhe dokumente zyrtare	7 Certifikata dhe dokumente zyrtare	9,500	9,500	9,800	10,500
Dokumentet që lidhen me statusin social, si dhe lindjen, tjetër	Dokumentet që lidhen me statusin social, si dhe lindjen, tjetër	9,500	9,500	9,800	10,500
8 Tatimi në pronë	8 Tatimi në pronë	25,000	29,000	29,957	29,000
Pagesa e tatimit në pronë	Pagesa e tatimit në pronë	25,000	28,000	28,957	29,000

9 Të	9 Të ardhura të tjera	58,764	34,385	36,044	36,862
Pagesat e	Pagesat e tjera	58,764	34,385	36,044	38,961
I-A.	I-A. Nëntotali I-A, të ardhurat direkte (tarifat dhe	5,600	5,600	5,000	6,000
trafikut të	Gjohat e trafikut të mbledhura përmes nivelit qendror	2,600	2,600	2,000	3,000
gjykatës	Gjohat e gjykatës dhe Agjencia Pyjore	3,000	3,000	3,000	3,000
SHUMË E TË ARDHURAVE KOMUNALE		108.185	107.898	112.281	117.837

Komuna e Ranilug vazhdon të dominohet në buxhetin total të saj nga transferet qeveritare të cilat edhe në tri vitet e ardhshme do të përbëjnë më shumë se 80% të buxhetit total të komunës.

3.2.1. Donacionet e jashtme (ndërkombëtare)

Shuma totale e finacuar nga donatorët e jashtëm, në realizimin e projekteve të ndryshme për Komunë.

Komuna nuk ka planifikuar donacione të jashtmenë kornizën Vjetore buxhetore, pasi që nuk kemi marrveshje të nënshkruar me ta, eventualisht angazhimet e mahershme, po rre bisedë me ta,

3.2.2 Politikat e reja

Komuna e Ranilug në tri vitet e ardhshme do të bëjë përpjekje në mobilizimin e resurseve komunale me qëllim të adoptimit të politikave të reja që ka inicuar qeveria nacionale e Republikës së Kosovës, por edhe të atyre të inicuar në nivelin e qeverisë komunale.

Si rezultat i procesit të decentralizimit Komuna e Ranillugut pret rritje të bazës së saj tatimore për pronat e paluajtshme të cilat janë pjesë e territorit të Komunës nga aplikimi i procesit të decentralizimit dhe rrjedhimisht rritje të hyrash vetanake. Rritja e bazës tatimore komunale si rezultat i procesit të decentralizimit duket kështu:

Para procesit të decentralizimit		Pas procesit të decentralizimit	
Nr i objekteve të tatimuara në Komunë	Shuma e përgjithshme e faturuar në vit në Euro	Nr i objekteve të tatimuara në Komunë	Shuma e përgjithshme e faturuar në vit në Euro

Një aspekt tjetër i rritjes së planit për të hyra nga Tatimi në Pronë si i vetmi tatim me relevancë në Komunë është rritja e normave tatimore si rezultat i amandamentimit të Ligjit mbi Pronën e Paluajtshme, ku minimumi i normës tatimore është bërë 0.15%. Për Komunën e Ranilug për vitet 2024-2026 kjo ka shënuar një rritje norme tatimore për 0.7% krahasuar me atë që është duke aplikuar në vitin 2021.

Tabela 4: Shuma e tatimit në pronë e vlerësuar për 2022, me normat aktuale tatimore dhe ato të ngritura

Komuna	Numri i faturave tatimore	Shuma aktualisht e vlerësuar tatimore	Fatura mesatare aktuale	Shuma e vlerësuar tatimore me normë të ngritur në 0.15%	Fatura mesatare me normë të ngritur tatimore në 0.15%
Ranilug					

Burimi: Databaza e Tatimit në Pronë për Komunën e Novobërdës, Ministria e Ekonomisë dhe Financave

Gjithashtu, me procesin e decentralizimit dhe mobilizimit të të hyrave vetanake, Komuna e Ranillugut ka rritur planin afatmesëm të realizimit të të hyrave vetanake, edhe nga lejet e ndërtimit. Kjo vjen si rezultat i rritjes së kërkesave për ndërtime të reja në territorin e zgjeruar të komunës gjatë procesit të decentralizimit.

Ndryshe, ndonëse ende nuk është pjesë e Kornizës Vjetore të Shpenzimeve të Qeverisë së Kosovës 2024-2026, sygjerimit të Qeverisë së Kosovës janë që shumica e Grantit të Përgjithshëm të komunave që aktualisht është dhjetë përqind (10%) e të hyrave totale të buxhetuara të Qeverisë qendrore, (duke përjashtuar të hyrat nga shitja e aseteve, të hyrat tjera të jashtëzakonshme, të hyrat e dedikuara vetanake dhe të hyrat nga huamarrja) do të reduktohet në 8%, në vitet e ardhshme. Projektionet e bëra për 2023 dhe 2025 në Kornizën Vjetore të Shpenzimeve të Kosovës, nuk reflektojnë ende këtë politikë. Për Komunën e Ranillugut kjo do të vazhdojë të jetë një risk që duhet trajtuar në të ardhmen dhe menduar strategjitë që duhet ndjekur me qëllim të mbulimit të asaj difference që do të shkaktonte ulja e nivelit të grantit të përgjithshëm, për komunën.

Së dyti, në rast se në periudhën Vjetore Qeveria e Kosovës do të ndryshojë formulën shteterëore të ndarjes së grantit të arsimit për Komuna, ndarje kjo që pretendohet të bëhet në bazë të normës e jo të numrit të nxënësve, atëherë kjo do të ketë ndikim të dukshëm në buxhetin e Komunës, ulë grantin e arsimit, sidomos pas parasysh se ky grant përbën pjesën më të madhe të buxhetit komunal.

Së treti, Komuna e Ranillugut ndonëse me informata të limituara do të jetë e ndikuar në aspektin buxhetor edhe me rastin e fillimit të aplikimit të Ligjit për gradim në paga për shërbyesit civil të Kosovës, ndonëse ende nuk është bërë ndonjë analizë në lidhje me ndikimin fiskal apo buxhetin e Komunës. Tutje, Komuna nuk posedon me informatat e nevojshme për të bërë këtë analizë, të cilën në të ardhmen ndoshta do ta ofronte Ministria e Administratës Publike.


Së katërti, sa i përket politikave të reja ose atyre të paralajmëruara nga niveli qendror, me ndikim në Komunën e Ranilug, është edhe politika që do të zgjedhet nga viti 2023 e tutje, në lidhje me trajtimin e mirëqenies sociale si kompetencë e decentralizuar në komunat e Kosovës. Komuna e Ranilug aktualisht nuk posedon informatat e nevojshme në lidhje me mënyrën e ndarjes buxhetore që do të bëhet për financimin kësaj fushe, ndryshe nga ajo që është aktualisht, ndonëse ka paralajmërim nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Ministria e Financave sa i përket këtyre politika.

Së pesti, Komuna e Ranillugut do të mirëpreste deklaratimet e Qeverisë Nacionale, që në të ardhmen, sa i përket fleksibilitetit të shpenzimeve në të gjitha kategoritë ekonomike, përveç pagave, të kenë mundësi këtë ta bëjnë edhe nga Granti i Përgjithshëm si shtesë, përveç se nga të hyrave vetanake komunale.

3.3 Tendanca e shpenzimeve komunale dhe parashikimi i tyre afat-mesëm 2024-2026

Sipas Qarkores Buxhetore Komunale 2023 – 2025, komunat do të kenë edhe në të ardhmen fleksibilitet në shpërndarjen e të hyrave vetanake komunale në strukturën e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike për vitin 2023, duke përjashtuar kategorinë Paga dhe Mëditje. Si rezultat Komuna e Ranillugut prezanton këtë ndarje të shpenzimeve në mes të kategorive të lejuara buxhetore:

Figura 2: Shpenzimet komunale në kategori ekonomike, 2024-2026



3.3.1 Pagat dhe Mëditjet – Gjatë vitit 2023 krahasuar me vitin 2022, kjo kategori do të shenoj rritje të rrogave në nivelin vjetorë ritja e faturave në nivelin 0.5% në bazë të nenit 22C, pika 1.4; Ligjit nr.05/L-063.

3.3.2 Mallrat dhe Shërbimet - kategoria e shpenzimeve për mallra dhe shërbime (duke përfshirë komunalitetë), është paraqitur një rritje e vogël.

3.3.3 Subvencionet – kjo kategori e shpenzimeve gjatë vitit 2023 do të rritet ndjeshëm për të fuqizuar sektorin civil në komunën tonë, i cili ishte neglizhuar në vitet e kaluara.

3.3.4 Investimet Kapitale - kjo kategori e shpenzimeve do të shënojë rritje sidomos në vitin 2022, krahasuar me vitet e më hershme si rezultat i shpërndarjes më të madhe buxhetore në kategoritë e tjera ekonomike dhe rritjes së dedikuar në Paga Mëditje mallra dhe shërbime shërbime komunale si dhe projekte kapitale . Një pjesë e madhe e tyre planifikohet të financohet nga të hyrat vetanake të komunës. Ivestimet kapitale, nga buxheti i komunës do të vazhdojnë të kenë rritje në periudhën Vjetore.

Tabela 6: Korniza Buxhetore Komunale, në euro

Përshkrimi	2022 (buxheti aktual)	2023 (plani)	2024(vlerësi met)	2025(vlerësimet)
1. TË HYRAT TOTALE KOMUNALE	1.790.463	2.127.340	2.238.674	2.346.684
1.1 Të hyrat vetanake	108.185	112.801	117.767	118.400
1.2 Grantet dhe transferet qeveritare	1.682.278	2.014.539	2.120.907	2.228.284
2. SHPENZIMET TOTALE KOMUNALE	1.790.463	2.127.340	2.238.674	2.346.684
2.1 Shpenzimet rrjedhëse	1.517.400	1.781.050		
Pagat dhe mëditjet	1.137.400	1.410.000	1.420.000	1.434.200
Mallrat dhe shërbimet	250.000	250.000	260.000	270.000
Subvencionet	75.000	75.000	80.000	90.000
Komunalije	55.000	50.000	60.000	65.000
2.2 Shpenzimet Kapitale	273.063	342.340	418.674	487.484
Nga të cilat: Grantet e jashtme për projekte kapitale	0.00	0.00	0.00	0.00
3. BILANCI PRIMAR BUXHETOR	0.00	0.00	0.00	0.00
3.1 Pagesa e interesit për borxhin e jashtëm	0.00	0.00	0.00	0.00
4. BILANCI TOTAL BUXHETOR	0.00	0.00	0.00	0.00
5. FINANCIMI	0.00	0.00	0.00	0.00
5.1 Financimi i jashtëm	0.00	0.00	0.00	0.00
Ripagimi i borxhit kryesor	0.00	0.00	0.00	0.00
Huamarrja e jashtme	0.00	0.00	0.00	0.00
5.2 Financimi i brendshëm	0.00	0.00	0.00	0.00
Shitja e asetëve	0.00	0.00	0.00	0.00
Huamarrja e brendshme	0.00	0.00	0.00	0.00
Ndryshimi në fitimet e pashpërndara	0.00	0.00	0.00	0.00
6. BILANCI BANKAR NË FUND TË VITIT	0.00	0.00	0.00	0.00

Tabelat në vijim janë një pasqyrë e shpërndarjes së shpenzimeve komunale në bazë të programeve apo kategorive funksionale si dhe në bazë të kategorive ekonomike. Shpenzimet në vijim janë ato aktualet të vitit 2022, planifikimi për vitin e ardhshëm 2023 si dhe projeksionet e vitit 2024-2025. Vëreni se ndryshimet më të mëdha buxhetore janë të reflektuara në kategoritë ekonomike mallra dhe shërbime si dhe kapitale, dhe atë kryesisht në vitin 2021- si rezultat i fleksibilitetit të lejuar nga Ministria e Financave në shpërndarjen e të hyrave vetanake të komunës, në të gjitha kategoritë ekonomike (përveq pagave dhe mëditjeve) të lejuar duke filluar nga viti 2023. Ndërkaq që kjo rritje bëhet më shume e vërejtshme në projeksionet 2024-2025. Nevoja për këtë rritje në këto kategori ka qenë e

kahershme ndërkohë që limitet buxhetore të vendosura nga Ministria e Financave nuk kanë lejuar që kjo të ndodhë deri tashti.

Tabela 7: Shpenzimet Komunale 2023, të shpërndara në kategori ekonomike dhe programe

Programe	2023					
	Paga/Meditje	Mallra/Sherbime	Komunali	Subvencione	Investime Kapitale	Gjithsej
Zyra e Kryetari	74.800,00	180.697,00		75.000,00	47.000,00	372.497,00
Zyra e Kuvendit komunal	64.330,00					64.330,00
Administrata dhe Personeli	108.585,00	4.000,00				112.585,00
Buxhet dhe financa	74.574,00					74.574,00
Zyra Komunale per Komunitet	12.500,00					12.500,00
Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural	37.400,00					37.400,00
Kadastër, Gjeodezi, Urban	42.500,00				25.000,00	67.500,00
Sherbime publike	46.100,00		55.000,00		139.263,00	240.363,00
Shërbimet e shëndetësis primare	160.000,00				16.000,00	176.000,00
Shërbimet Sociale	26.000,00					26.000,00
Arsimi	464.611,00	65.303,00			45.800,00	575.714,00
Admistrata	26.000,00					
GJITHSEJ	1.137.400,00	250.000,00	55.000,00	75.000,00	273.063,00	1.790.463,00

Tabela 8: Shpenzimet Komunale 2024, të shpërndara në kategori ekonomike dhe programe

Programet	2024					
	Paga/Meditje	Mallra/Sherbime	Komunali	Subvencione	Investime Kapitale	Gjithsej
Zyra e Kryetari	90.800,00	180.700,00		75.000,00	100.000,00	446.500,00
Zyra e Kuvendit komunal	118.293,00					118.293,00
Administrata dhe Personeli	97.500,00	4.000,00				101.500,00
Buxhet dhe financa	80.800,00					80.800,00
Zyra Komunale per Komunitet	13.300,00					13.300,00
Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural	40.300,00					40.300,00
Kadastër, Gjeodezi, Urban	45.000,00					45.000,00
Sherbime publike	52.400,00		50.000,00		235.529,00	
Shërbimet e shëndetësis primare	198.402,00					198.402,00
Sherbimet Sociale	30.000,00					30.000,00
Arsimi	611.205,00	65.300,00			6.811,00	683.316,00
Admistrata	32.000,00					
GJITHSEJ	1.410.000,00	250.000,00	50.000,00	75.000,00	342.340,00	2.127.340,00

Tabela 9: Për shpenzime simbas kategorive dhe programeve ekonomike për vitin 2025

Programet	2025					
	Paga/Meditje	Mallra/Sherbime	Komunali	Subvencione	Investime Kapitale	Gjithsej
Zyra e Kryetari	91.800,00	190.000,00		80.000,00	50.000,00	411.800,00
Zyra e Kuvendit komunal	119.300,00					119.300,00
Administrata dhe Personeli	98.000,00				60.000,00	158.000,00
Buxhet dhe financa	81.500,00					81.500,00
Zyra Komunale per Komunitet	13.500,00					13.500,00
Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural	41.000,00	4.000,00				45.000,00
Kadastër, Gjeodezi, Urban	46.000,00					46.000,00
Sherbime publike	53.000,00		60.000,00		150.000,00	
Shërbimet e shëndetësis primare	200.000,00				20.000,00	220.000,00
Sherbimet Sociale	30.500,00					30.500,00
Arsimi	612.900,00	66.000,00			138.674,00	817.574,00
Admistrata	32.500,00					
GJITHSEJ	1.420.000,00	260.000,00	60.000,00	80.000,00	418.674,00	2.238.674,00

Tabela 10: Për shpenzime simbas kategorive dhe programeve ekonomike 2026

Programet	2026					
	Paga/Meditje	Mallra/Sherbime	Komunali	Subvencione	Investime Kapitale	Gjithsej
Zyra e Kryetari	92.800,00	200.000,00		90.000,00	87.484,00	470.284,00
Zyra e Kuvendit komunal	120.300,00					120.300,00
Administrata dhe Personeli	99.000,00				100.000,00	199.000,00
Buxhet dhe financa	83.000,00					83.000,00
Zyra Komunale per Komunitet	14.000,00					14.000,00
Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural	42.000,00					42.000,00
Kadastër, Gjeodezi, Urban	45.000,00				100.000,00	145.000,00
Sherbime publike	54.000,00		65.000,00		200.000,00	319.000,00
Shërbimet e shëndetësis primare	203.500,00					203.500,00
Sherbimet Sociale	31.500,00					31.500,00
Arsimi	616.100,00	70.000,00				686.100,00
Admistrata	33.000,00					33.000,00
GJITHSEJ	1.434.200,00	270.000,00	65.000,00	90.000,00	487.484,00	2.346.684,00

Kategoria Ekonomike – Investimet Kapitale - e prezantuar në detaje më poshtë paraqet një komponentë të rëndësishme të buxhetit të komunës e cila ndonëse nuk përfaqëson pjesën më të madhe të shpenzimeve të përgjithshme buxhetore, mbetet më rëndësi të posaqme në aspektin e planifikimit, për Komunën e Ranillugut. Kjo kategori e shpenzimeve në kuadër të shpenzimeve të rregullta buxhetore, ka potencialin më të madh për të nxitur rritjen ekonomike. Andaj, kjo kategori e shpenzimeve, edhe gjatë periudhës së ardhshme Vjetore, do të vazhdojë të jetë në funksion të krijimit të ambientit më të favorshëm për ngritje të pjesëmarrjes së sektorit privat, përmes përmirësimit të vazhdueshëm të infrastrukturës. Përderisa ndikimi i këtyre investimeve në punësim dhe konsum është relativisht i shpejtë, ndikimi i plotë i tyre në ekonomi do të mund të realizohet vetëm në periudhën Vjetore. Në këtë kontekst përmirësimi i infrastrukturës do të pozicionojë ekonominë e Komunës së Ranillugut në një rrugë të rritjes më të shpejtë dhe të qëndrueshme ekonomike në periudhën afatgjatë.

Tabela 11: Projektet Kapitale të komunës 2024-2026, dhe kostoja e asociuar me to në Euro

LISTA E PROJEKTEVE KAPITALE 2024			
Nr.	Programi	Emri i projekteve	Shuma
1.	Zhvillim ekonomik	Asfaltimi i rrugve lokale	*
		Participim ne projekte	*
		Mirmbajtja e rrugve lokale	*
		Investimet tjera Kapitale, material ndertimor	
		Gelqerosja e shkollave	
		Gelqerosja e Ambolantave	
		Ndertimi i kanalizimeve	
		Ndertimi i ndriqimit publik dhe mirmbajtje	
		Projekt Rezidencial	
	Total		342.340 €

- Dorëzuar për shqyrtim *

LISTA E PROJEKTEVE KAPITALE 2025

1.	Zhvillim Ekonomik	Asfaltimi i rrugëve lokale	20.000 €
		Pjesëmarrja në projekt	15.000 €
		Ndërtimi i shkollës M.	130.000 €
		Rikonstruksioni i shëtitores në hyrje të fshatit Ranillug	10.000 €
		Heqja e deponive dhe objekteve të fundësura në territorin e bashkisë	10.000 €
		Ndërtimi i parkut në fshatin Ranilug	60.000 €
		Blerja e automjeteve dhe minibusëve	97.340 €
	Total		418.674 €

LISTA E PROJEKTEVE KAPITALE 2026			
Nr.	Programi	Emri i projekteve	Shuma
1.	Zhvillim ekonomik	Asfaltimi i rrugve lokale	*
		Participim ne projekte	*
		Mirmbajtja e rrugve lokale	*
		Paisje Bujqesore	
		Gelqerosja e shkollave	
		Gelqerosja e Ambolantave	
		Ndertimi i kanalizimeve	
		Ndertimi i ndriqimit publik dhe mirmbajtje	
		Projekt Rezidencial	
	Total		487.484 €

- Dorëzuar për shqyrtim *


 Drejtori i departamentit
 (Nikola Arsić)